



6-12 TETOR

JAVA E MBROJTJES

Cyber D



ce C

TIRANA, ALBANIA
9-10 OCTOBER 2025

KONFERENCA E MBROJTJES KIBERNETIKE TË NATO-S NË SHQIPËRI

Konferenca e Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s 2025, u zhvillua në Tiranë dhe mbledhi së bashku gjeneralë, komandantë, drejtues të lartë të Aleancës, si dhe ekspertë ndërkombëtarë në fushën e Sigurisë Digjitale. Ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, në fjalën e tij përpara pjesëmarrësve, theksoi rëndësinë strategjike të Mbrojtjes Kibernetike në kohën kur hapësira digjitale është kthyer në një ndër dimensionet më kritike të sigurisë kolektive.

★★★★★

mod.gov.al

JM

ZYRTARI I NATO-S NË TIRANË

Më 7 dhe 8 tetor 2025, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë pritën për një vizitë zyrtare drejtorin e Zyrës së Standardizimit të NATO-s (NSO), gjeneralmajor Thierry Poulette. Vizita u zhvillua në kuadër të përpjekjeve për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe strukturave të Aleancës në fushën e standardizimit, si dhe për të forcuar rolin e vendit tonë në këtë proces të rëndësishëm për ndërveprueshmërinë ushtarake.

★★★★★



SHQIPËRIA FORCON SIGURINË KIBERNETIKE

Në Komandën Kibernetike dhe Ndërlidhjes, qendër kyçe e strategjisë “Mbrojtja 2030”, u diskutua plani për rritjen e kapaciteteve dhe integrimin e inovacionit në të gjithë aktivitetin ushtarak dhe civil të Forcave të Armatosura. Ky zhvillim vjen pas ngjitjes së Shqipërisë në vendin e 15-të në botë në Indeksin Kombëtar të Sigurisë Kibernetike (NCSI).

JM

★★★★★

VITI I RI AKADEMIK NË AFA

Akademia e Forcave të Armatosura (AFA) nisi zyrtarisht viti i ri akademik. Në fjalën e tij përshëndetëse gjatë ceremonisë, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu uroi studentët për nisjen e vitit të ri akademik, duke theksuar se ata kanë zgjedhur një nga institucionet më cilësore të arsimit të lartë në vend. Ministri nënvizoi se interesi për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura është rritur ndjeshëm vit pas viti.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

SUKSES I REGJIMENTIT TË JUGUT NË GARËN “CAMBRIAN PATROL”

Regjimenti i Jugut i Forcës Tokësore mori pjesë në një nga garat më të vështira ushtarake në botë, “Cambrian Patrol”, zhvilluar në Uells nga Brigada e 160-të e Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar. 48 orë sfidë në terren të ashpër, në një garë me traditë mbi 60-vjeçare, ku trupat tona u renditën me meritë në vendin e tretë.

JM

★★★★★

mod.gov.al

OPERACIONE EOD OPERACIONE NË DISA BASHKI

Operatorët EOD të Batalionit të Xhenios kanë zhvilluar operacione në mbështetje të autoriteteve civile në bashkitë Shkodër, Këlcyrë, Himarë dhe Kuçovë. Ata kanë kontrolluar zona të ndryshme me aparate metalkërkuese, duke identifikuar municione të kalibrave të ndryshëm. Ky angazhim synon rritjen e sigurisë së jetës dhe pronës së qytetarëve.

★★★★★

KURSANTËT E KOLEGJIT TË MBROJTJES DHUROJNË GJAK

Në kuadër të nismës “Dhuro gjak, shpëto jetë”, stafi drejtues, pedagogët dhe kursantët e Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, të udhëhequr nga kolonel Luli Florini, dhuruan gjak, duke treguar përgjegjësi, solidaritet dhe shembull qytetarie aktive.

JM



ANIJA “LISSUS” SHPËTON 35 EMIGRANTË NË DETIN EGJE

Efektivët e anijes P-133 “Lissus”, gjatë patrullimit në detin Egje, i erdhën në ndihmë një gomoneje me 35 emigrantë nga Eritrea, Afganistani, Palestina, Iraku dhe Egjipti. Ndërhyrja u bë pjesë e misionit të përbashkët për sigurinë detare.

JM



THIRRJE PËR STUDIME USHTARAKE NË SHBA

Qendra e Personel Rekrutimit njofton hapjen e aplikimeve për tre kuota studimi në akademitë ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës: një në Akademinë Ushtarake West Point, një në Akademinë Detare dhe një në Akademinë e Forcave Ajrore. Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve është 14 nëntor 2025.

JM

